**LIGJ**
**Nr. 115/2026**

**PËR KËSHILLIN FISKAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Qëllimi**

Ky ligj përcakton kuadrin ligjor për krijimin, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Këshillit Fiskal të Republikës së Shqipërisë (në vijim Këshilli Fiskal), si person juridik publik i pavarur, me qëllim kontributin në disiplinën fiskale, transparencën dhe qëndrueshmërinë e financave publike, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Neni 2
**Përkufizime**

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "**Këshilli Fiskal**" është institucion i pavarur, i krijuar në bazë të këtij ligji për të monitoruar politikën fiskale e për të kontribuuar në disiplinën fiskale, transparencën dhe qëndrueshmërinë e financave publike.

2. "**Parimet dhe rregullat fiskale**" janë kufizimet numerike dhe procedurale mbi politikën fiskale, të përcaktuara në nenin 4/1, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kufijtë e borxhit, objektivat e deficitit dhe tavanet e shpenzimeve.

3. "**Ligji organik i buxhetit**" është ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

---

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit (BE) 2024/1265, datë 29 prill 2024, që ndryshon direktivën 2011/85/BE (OJ L 306, 23.11.2011, fq.41), mbi kërkesat për kuadrot buxhetore të shteteve anëtare, nr. CELEX, (OJ L, 2024/1265, 30.4.2024) ELI: http://data.europa.eu/eli/dir/2024/1265/oj.*

4. “**Trajektorja e shpenzimeve neto**” është trajektorja shumëvjeçare e shpenzimeve primare neto, siç do të përcaktohet nga Këshilli i Bashkimit Evropian pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

5. “**Qëndrueshmëria e financave publike**” është aftësia e qeverisë për të ruajtur politikat aktuale të shpenzimeve, të tatimeve dhe politikat e tjera, pa vënë në rrezik aftësinë paguese dhe pa cenuar përmbushjen e detyrimeve ose të shpenzimeve të angazhuara.

6. “**Qeverisja e përgjithshme**” janë të gjitha njësitë institucionale të qeverisjes qendrore, të qeverisjes vendore dhe fondet speciale, sipas përcaktimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA).

7. “**Rreziqet fiskale**” janë faktorët që mund të shkaktojnë devijime të rezultateve fiskale nga parashikimet, përfshirë goditjet makroekonomike, detyrimet kontigjente të kushtëzuara dhe rreziqet që lidhen me zbatimin e politikave.

8. “**Buxheti vjetor**” është buxheti i shtetit i Republikës së Shqipërisë, i miratuar nga Kuvendi, për një vit fiskal.

9. “**Vendimi i Këshillit të Ministrave për kuadrin makroekonomik dhe fiskal afatmesëm**” është raporti për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike e buxhetore, sipas nenit 23 të ligjit organik të buxhetit.

10. “**Njësi publike**”, për qëllime të këtij ligji, është çdo subjekt që është pjesë e qeverisjes së përgjithshme ose kontrollohet prej saj.

11. “**Konflikt interesi**” është çdo situatë në të cilën interesat privatë të një anëtari të Këshillit Fiskal ose të një punonjësi të tij mund të ndikojnë ose duket se ndikojnë në kryerjen e paanshme dhe objektive të detyrave, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

## Neni 3
## **Statusi juridik**

1. Këshilli Fiskal krijohet si institucion i pavarur dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli Fiskal raporton drejtpërdrejt në Kuvend, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Këshilli Fiskal gëzon personalitet juridik dhe i ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga çdo subjekt tjetër publik ose privat.

## Neni 4
## **Fusha e veprimtarisë**

1. Këshilli Fiskal monitoron zbatimin e parimeve, rregullave dhe kufizimeve fiskale, të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit, vlerëson zhvillimet e politikës fiskale dhe jep opinione të pavarura për qëndrueshmërinë e financave publike dhe rreziqet fiskale.

2. Këshilli Fiskal nuk merr pjesë në formulimin ose hartimin e politikave fiskale dhe buxhetore, nuk harton parashikime makroekonomike për qëllime të

politikëbërjes së qeverisë dhe nuk ushtron funksione ekzekutive që sipas legjislacionit në fuqi i janë ngarkuar ministrisë përgjegjëse për financat ose autoriteteve të tjera publike. Këshilli Fiskal ushtron vetëm funksione të pavarura vlerësuese, monitoruese, analizuese dhe raportuese, në përputhje me këtë ligj.

## KREU II
## DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT FISKAL

### Neni 5
### **Detyrat e Këshillit Fiskal**

1. Këshilli Fiskal përgatit analiza dhe opinione të pavarura, objektive e profesionale, lidhur me:

a) zbatimin e parimeve dhe rregullave fiskale të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit, si dhe rreziqet për devijimin prej tyre;

b) zbatimin e përcaktimeve të pikave 1 dhe 5, të nenit 4/2 të ligjit organik të buxhetit, si dhe rreziqet për devijimin prej tyre;

c) zbatimin e përcaktimeve të nenit 4/3 të ligjit organik të buxhetit, si dhe rreziqet për devijimin prej tyre;

ç) ndodhjen dhe vlefshmërinë e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4, të ligjit organik të buxhetit, të cilat kanë sjellë devijime të përkohshme nga zbatimi i parimeve dhe rregullave fiskale të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit;

d) projektvendimin e Këshillit të Ministrave për kuadrin makroekonomik dhe fiskal afatmesëm, sipas nenit 23 të ligjit organik të buxhetit, duke përfshirë vlerësimin nëse parashikimet makroekonomike për të cilat ai mbështetet janë të kujdesshme dhe të besueshme;

dh) projektbuxhetin vjetor fillestar, si dhe ndryshimet dhe rishikimet e tij, duke përfshirë vlerësimin nëse parashikimet makroekonomike për të cilat ai mbështetet janë të kujdesshme dhe të besueshme;

e) raportin e konsoliduar vjetor të zbatimit të buxhetit që i paraqitet Kuvendit;

ë) rreziqet fiskale;

f) konsistencën, koherencën dhe efektivitetin e kuadrit kombëtar buxhetor, duke përfshirë vlerësimin nëse objektivat fiskalë janë në përputhje me njëri-tjetrin, nëse kuadri është efektiv për arritjen e qëllimeve të politikës fiskale dhe nëse procesi buxhetor mbështet realizimin e këtyre objektivave.

2. Pas bërjes së detyrueshme të zbatimit të Rregullores (BE) 2024/1263 dhe të rregullores (KE) nr. 1467/97, për Republikën e Shqipërisë, Këshilli Fiskal, përveç detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kryen edhe detyrat e mëposhtme:

a) jep opinion për parashikimet dhe supozimet makroekonomike për të cilat bazohet trajektorja e shpenzimeve neto në planin kombëtar fiskalo-strukturor afatmesëm, në përputhje me nenet 11 dhe 15(3) të rregullores (BE) 2024/1263;

b) vlerëson përputhshmërinë e të dhënave të realizimit buxhetor të raportuara në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit me trajektoren e shpenzimeve neto, të

përcaktuar nga institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe analizon faktorët që qëndrojnë në themel të çdo devijimi prej saj, në përputhje me nenin 23, të rregullores (BE) 2024/1263;

c) vlerëson mjaftueshmërinë e masave të marra dhe të planifikuara gjatë periudhës së përshtatjes në raport me objektivat përkatës, në përputhje me pikën 5, të nenit 3 të rregullores (KE) nr. 1467/97.

3. Ministria përgjegjëse për financat i paraqet Këshillit Fiskal dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni së bashku me të dhënat mbështetëse dhe supozimet përkatëse, në format elektronik të editueshëm, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara afatit të paraqitjes së tyre pranë institucioneve të Bashkimit Evropian për t'i mundësuar Këshillit Fiskal shqyrtimin e tyre dhe përgatitjen e opinionit ose vlerësimit të tij. Opinionet dhe vlerësimet e Këshillit Fiskal publikohen dhe i bashkëlidhen dokumentit përkatës që u paraqitet institucioneve të Bashkimit Evropian.

4. Analizat dhe opinionet e Këshillit Fiskal, të përcaktuara në shkronjat "d" dhe "dh", të pikës 1 të këtij neni, janë pjesë përbërëse e dokumenteve përkatëse, që i paraqiten Këshillit të Ministrave ose Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Ministria përgjegjëse për financat i përcjell Këshillit Fiskal, në format elektronik të editueshëm, të gjitha dokumentet dhe materialet shoqëruese përkatëse përpara paraqitjes për miratim në Këshillin e Ministrave të projektligjit të buxhetit vjetor ose të projektvendimit të Këshillit të Ministrave për kuadrin makroekonomik dhe fiskal afatmesëm.

6. Këshilli Fiskal paraqet opinionin e tij zyrtar për projektligjin e buxhetit vjetor ose projektvendimin e Këshillit të Ministrave për kuadrin makroekonomik dhe fiskal afatmesëm pranë ministrisë përgjegjëse për financat brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentacionit.

7. Nëse në analizat dhe opinionet e Këshillit Fiskal për projektligjin e buxhetit vjetor ose për projektvendimin e Këshillit të Ministrave për kuadrin makroekonomik dhe fiskal afatmesëm ka vërejtje negative, ministria përgjegjëse për financat përgatit një relacion shpjegues, si pjesë përbërëse e dokumenteve që i paraqiten Këshillit të Ministrave dhe, në rastin e buxhetit vjetor, komisionit parlamentar përgjegjës për financat, në të cilin shpjegon arsyet e devijimeve, nëse ka, nga analizat dhe opinionet e Këshillit Fiskal. Në raste të tilla, komisioni parlamentar përgjegjës për financat zhvillon seanca dëgjimore në lidhje me opinionin e Këshillit Fiskal. Relacioni shpjegues i ministrisë përgjegjëse për financat bëhet publik jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e dhënies së analizës ose e opinionit përkatës të Këshillit Fiskal.

8. Këshilli Fiskal, me nismën e vet, mund të përgatisë analiza dhe opinione për efektet fiskale të projektakteve të veçanta, të vlerësojë mjaftueshmërinë e masave të marra ose të planifikuara gjatë periudhës së përshtatjes në raport me objektivat përkatës, si dhe të trajtojë çështje të tjera që lidhen me politikën fiskale dhe menaxhimin e financave publike. Këshilli Fiskal ushtron funksione analizuese e vlerësuese dhe nuk është përgjegjës për formulimin ose hartimin e politikave.

9. Këshilli Fiskal, me ftesë, merr pjesë në seanca dëgjimore dhe në diskutime në Kuvend.

## KREU III
## TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT FISKAL

### Neni 6
### **Struktura dhe mandati i Këshillit Fiskal**

1. Këshilli Fiskal përbëhet nga 3 (tre) anëtarë.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Fiskal është 6 (gjashtë) vjet, me mundësi riemërimi vetëm një herë. Mandatet e anëtarëve organizohen në mënyrë të shkallëzuar, në mënyrë që mandati i jo më shumë se një anëtari të përfundojë brenda të njëjtit vit kalendarik. Shkallëzimi i mandateve përcaktohet përmes mandateve fillestare të përbërjes së parë të Këshillit Fiskal, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.

3. Anëtarët e Këshillit Fiskal e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me marrëdhënie pune me kohë të plotë.

4. Për ushtrimin e detyrave të tyre në Këshillin Fiskal, anëtarët përfitojnë pagë mujore. Paga mujore e kryetarit të Këshillit Fiskal është e barabartë me pagën e ministrit, ndërsa paga mujore e anëtarëve të tjerë është në masën 85 për qind të pagës së kryetarit.

5. Anëtarët e Këshillit Fiskal gjatë kryerjes së punës së tyre veprojnë në mënyrë autonome, të pavarur e të paanshme, në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe etike. Ata nuk marrin udhëzime nga autoritetet buxhetore përkatëse ose nga çdo organ tjetër publik apo privat. Ata nuk marrin pjesë në veprimtari politike dhe nuk shprehin publikisht bindje politike.

### Neni 7
### **Procedura e emërimit të anëtarëve të Këshillit Fiskal**

1. Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Fiskal, komisioni parlamentar përgjegjës për financat shpall një thirrje publike për përzgjedhjen e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

2. Thirrja publike qëndron e hapur për jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare, në të paktën një media të shtypit kombëtar, si dhe në faqen zyrtare të Kuvendit.

3. Komisioni parlamentar përgjegjës për financat, pas përfundimit të afatit të aplikimit, verifikon e vlerëson përmbushjen e kritereve nga kandidatët dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe në thirrjen publike. Komisioni zhvillon një intervistë publike me kandidatët e përzgjedhur dhe mbi këtë bazë i propozon Kuvendit 3 (tre) kandidatë për emërim, si anëtarë të Këshillit Fiskal.

4. Anëtarët e Këshillit Fiskal emërohen nga Kuvendi me shumicë votash, prej më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

5. Në rast se ndonjë prej kandidatëve të propozuar nuk merr shumicën e kërkuar për emërim, komisioni parlamentar përgjegjës për financat shpall menjëherë një thirrje të re publike për paraqitjen e kandidaturave.

6. Jo më vonë se 6 muaj përpara përfundimit të mandatit të një anëtari të Këshillit Fiskal, kryetari i Këshillit Fiskal njofton komisionin parlamentar përgjegjës për financat për përfundimin e mandatit përkatës.

7. Pas marrjes së njoftimit, komisioni parlamentar përgjegjës për financat fillon menjëherë procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin e një anëtari të ri, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 8

**Kriteret kryesore për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Fiskal**

1. Anëtarët e Këshillit Fiskal duhet të përmbushin standarde të larta të integritetit profesional dhe etik. Ata nuk mund të mbajnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, funksione politike, të jenë anëtarë të partive politike apo të ushtrojnë veprimtari që mund të krijojnë ndikim politik ose konflikt interesi. Anëtarët e ushtrojnë detyrën e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale.

2. Gjatë 2 (dy) vjetëve para emërimit, anëtarët e Këshillit Fiskal nuk duhet të kenë ushtruar funksione politike, të kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike ose të kenë qenë të punësuar në administratën publike.

3. Anëtarët duhet të zotërojnë diplomë universitare të nivelit “master” ose “doktoraturë” në ekonomi, financa publike, makroekonomi, ekonometri, statistikë, financë ose fusha të tjera të lidhura ngushtë me to.

4. Anëtarët duhet të kenë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vjet përvojë profesionale të provuar në fushën e financave publike, makroekonomisë ose kërkimit shkencor në fushën e ekonomisë.

5. Anëtarët e Këshillit Fiskal nuk duhet të jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

6. Për anëtarët e Këshillit Fiskal zbatohet legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për deklarimin dhe kontrollin e pasurive.

Neni 9

**Përfundimi i mandatit dhe procedura e shkarkimit**

1. Mandati i një anëtari të Këshillit Fiskal mbaron në rastet e mëposhtme:

a) me përfundimin e mandatit;

b) në rast vdekjeje;

c) me dorëheqje, të paraqitur me njoftim me shkrim të paktën 1 muaj përpara datës në të cilën dorëheqja hyn në fuqi;

ç) me shkarkim.

2. Një anëtar i Këshillit Fiskal shkarkohet nga detyra në rastet kur:

a) nuk përmbush më një nga kriteret e emërimit si anëtar i Këshillit Fiskal, të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji;

b) ka kryer shkelje të rëndë të detyrimeve të përcaktuara në nenin 6, pika 5, në nenin 8, pika 1, ose në nenin 18 të këtij ligji;

c) është i paaftë të ushtrojë detyrat për shkak të pamundësisë fizike ose mendore, që zgjat për më shumë se 3 muaj;

ç) nuk ushtron detyrat e tij në Këshillin Fiskal për një periudhë të pandërprerë, prej të paktën 2 muajsh, ose mungon në tri mbledhje radhazi;

d) ka humbur zotësinë për të vepruar.

3. Për rastet e parashikuara në shkronjat "a", "c" dhe "d", të pikës 2 të këtij neni, komisioni parlamentar përgjegjës për financat, me njoftim të Këshillit Fiskal, verifikon ekzistencën e shkakut. Për rastet e parashikuara në shkronjat "b" dhe "ç", të pikës 2, procedura nis me propozimin unanim të anëtarëve të tjerë të Këshillit Fiskal, i cili i paraqitet me shkrim komisionit, së bashku me arsyet e propozimit. Përpara se t'i propozojë Kuvendit shkarkimin, komisioni i jep anëtarit mundësinë të dëgjohet. Vendimi për shkarkimin merret nga Kuvendi me shumicë votash prej më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Pozicioni vakant në Këshillin Fiskal plotësohet jo më vonë se 90 ditë nga krijimi i tij, nëpërmjet emërimit të një anëtari të ri me mandat 6-vjeçar, sipas procedurave të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji.

5. Me përfundimin e mandatit, sipas shkronjës "a", të pikës 1 të këtij neni, anëtari vazhdon ushtrimin e detyrës deri në emërimin e pasardhësit, por jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

Neni 10

**Kryetari i Këshillit Fiskal**

1. Anëtarët e Këshillit Fiskal zgjedhin ndërmjet tyre kryetarin e Këshillit Fiskal.

2. Kryetari zgjidhet ndërmjet anëtarëve të Këshillit Fiskal për një mandat prej 2 (dy) vjetësh, me rotacion. Radha e rotacionit përcaktohet me short në mbledhjen e parë, me përjashtim të rastit kur një anëtar heq dorë vullnetarisht nga e drejta e tij për të shërbyer si kryetar.

3. Kryetari i Këshillit Fiskal:

a) përfaqëson, drejton dhe organizon punën e Këshillit Fiskal;

b) thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Fiskal dhe përcakton rendin e ditës;

c) thërret e drejton takimet e punës dhe ato profesionale të Këshillit Fiskal;

ç) nënshkruan aktet e miratuara në mbledhjet e Këshillit Fiskal;

d) paraqet për dijeni pranë komisionit parlamentar përgjegjës për financat projektrregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Fiskal, si dhe projektakte të tjera në fushën e kompetencës së tij, përfshirë, sipas rastit, propozime për ndryshimin dhe plotësimin e tyre;

dh) propozon nisma, rekomandime dhe udhëzime brenda fushave të kompetencës së Këshillit Fiskal.

KREU IV
SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT FISKAL

Neni 11
**Organizimi dhe funksionimi i sekretariatit teknik**

1. Këshilli Fiskal mbështetet në veprimtarinë e vet profesionale dhe teknike nga sekretariati teknik i Këshillit Fiskal.

2. Sekretariati teknik përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me marrëdhënie pune me kohë të plotë.

3. Anëtarët e sekretariatit teknik emërohen nga Këshilli Fiskal nëpërmjet një procedure konkurrimi publik, mbi bazën e meritës, kualifikimeve profesionale dhe përshtatshmërisë për funksionin, si më poshtë:

a) të mos mbajnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, funksione politike, të mos jenë anëtarë të partive politike dhe të mos ushtrojnë veprimtari që mund të krijojnë ndikim politik ose konflikt interesi;

b) të zotërojnë diplomë universitare të ciklit të dytë (master) në ekonomi, financa publike, makroekonomi, ekonometri, statistikë, financë ose fusha të tjera të ngjashme;

c) të kenë jo më pak se 7 (shtatë) vjet përvojë profesionale, të provuar në fushën e financave publike, makroekonomisë ose kërkimit ekonomik.

4. Paga mujore e anëtarëve të sekretariatit teknik është e barabartë me pagën e sekretarit të Përgjithshëm të një ministrie.

5. Në kryerjen e detyrave të tyre, anëtarët e sekretariatit teknik veprojnë në mënyrë të pavarur e të paanshme, nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga asnjë subjekt publik ose privat apo individ dhe i përgjigjet vetëm Këshillit Fiskal.

6. Këshilli Fiskal, përveç sekretariatit teknik, mbështetet nga personel administrativ për funksionet e financës, të burimeve njerëzore, të prokurimit dhe të arkivit.

7. Struktura organizative dhe organika e Këshillit Fiskal miratohen me vendim të Kuvendit, me propozim të Këshillit Fiskal.

KREU V
ORGANIZIMI DHE MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT FISKAL

Neni 12
**Organizimi i mbledhjeve të Këshillit Fiskal**

1. Këshilli Fiskal zhvillon mbledhje të rregullta në përputhje me rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij.

2. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Fiskal janë të detyruar të marrin pjesë rregullisht në mbledhje e të kontribuojnë në mënyrë aktive në përgatitjen e shqyrtimin e analizave, opinioneve dhe akteve të tjera që miratohen nga Këshilli Fiskal.

3. Mbledhjet e Këshillit Fiskal janë të vlefshme vetëm kur në to marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij.

4. Në përjashtim nga pika 3 e këtij neni, mbledhja është e vlefshme edhe me pjesëmarrjen e dy anëtarëve, kur pjesëmarrja e anëtarit të tretë është e pamundur, për shkak të një vendi vakant, paaftësisë së përkohshme, konfliktit të interesit ose mungesës së justifikuar. Shkaku i mungesës pasqyrohet në procesverbal dhe në çdo akt të miratuar me këtë përbërje. Në këto raste, Këshilli Fiskal nuk mund të miratojë ose të ndryshojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij dhe as të zgjedhë kryetarin.

5. Mbledhjet e Këshillit Fiskal zhvillohen me dyer të mbyllura, me përjashtim të rasteve kur vetë Këshilli vendos që mbledhje të caktuara të jenë me praninë e medieve.

6. Në mbledhjet e Këshillit Fiskal marrin pjesë anëtarët e sekretariatit teknik, pa të drejtë vote.

7. Këshilli Fiskal mund të ftojë edhe persona të tjerë për të marrë pjesë në mbledhjet e tij, kur prania e tyre vlerësohet e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve të veçanta të rendit të ditës.

8. Këshilli Fiskal miraton dhe publikon jo më vonë se data 15 dhjetor të çdo viti programin vjetor të punës për vitin pasardhës, në të cilin përcakton në mënyrë të pavarur veprimtaritë, produktet dhe afatet e realizimit të tyre. Këshilli Fiskal organizon dhe prioritizon veprimtarinë e tij, duke garantuar, në çdo rast, përmbushjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji. Ecuria e zbatimit të programit vjetor të punës pasqyrohet në raportin vjetor të veprimtarisë së Këshillit Fiskal.

Neni 13

**Vendimmarrja dhe procedurat e votimit**

1. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Fiskal kanë të drejtën dhe detyrimin për të votuar për çdo propozim të paraqitur për vendimmarrje në mbledhjet e Këshillit Fiskal.

2. Vendimet e Këshillit Fiskal merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Anëtarët janë të detyruar të votojnë dhe nuk lejohet të abstenojnë. Kur ka barazi votash ndërmjet anëtarëve të pranishëm, vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Fiskal miratohet nga të gjithë anëtarët e tij, me votim unanim, dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit Fiskal.

KREU VI

INFORMIMI PUBLIK DHE FINANCIMI

Neni 14

**Mbështetja buxhetore dhe autonomia financiare**

1. Këshilli Fiskal financohet nga buxheti i shtetit. Fondet për funksionimin e Këshillit Fiskal parashikohen si zë i veçantë buxhetor në ligjin vjetor për buxhetin.

2. Fondet e nevojshme për funksionimin e Këshillit Fiskal, duke përfshirë shpenzimet operative dhe materiale, duhet të sigurohen nga buxheti i shtetit.

3. Këshilli Fiskal paraqet kërkesën e tij buxhetore, përfshirë edhe nevojat për shërbime mbështetëse administrative, në përputhje me rregullat, procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

4. Marrëdhëniet e punës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

5. Këshilli Fiskal ushtron autonomi të plotë në përdorimin dhe menaxhimin e fondeve të alokuara.

6. Këshilli Fiskal, në veprimtarinë e tij financiare dhe në prokurimin e mallrave e të shërbimeve të nevojshme për funksionimin e tij, vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe i nënshtrohet auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 15

**Transparenca dhe raportimi**

1. Këshilli Fiskal paraqet në Kuvend një raport vjetor për veprimtarinë e tij, jo më vonë se fundi i muajit qershor të vitit aktual, për vitin kalendarik paraardhës.

2. Raporti vjetor përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një aneks për matjen e performancës, që përmban një përmbledhje statistikore të produkteve të realizuara kundrejt atyre të planifikuara; informacion për ecurinë e objektivave strategjike dhe nismave për përmirësim; në baza periodike 3-vjeçare, një vlerësim të saktësisë së projeksioneve të Këshillit Fiskal, në rastet kur projeksione të tilla janë përgatitura prej tij, si dhe çështje të tjera të përcaktuara në rregulloren e Këshillit Fiskal.

3. Këshilli Fiskal komunikon publikisht analizat e tij dhe e informon rregullisht publikun për veprimtarinë e tij përmes konferencave për shtyp, sesioneve informuese, njoftimeve publike, faqes së tij zyrtare të internetit dhe formave të tjera të përshtatshme të komunikimit. Analizat dhe opinionet e Këshillit Fiskal prezantohen nga kryetari ose nga një anëtar i caktuar prej tij dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit, pa vonesa të pajustifikuara.

4. Në daljet publike, anëtarët e Këshillit Fiskal paraqesin qëndrimet e miratuara në mbledhjet e Këshillit Fiskal. Në rastet kur një anëtar është shprehur me votim kundër, ai ka të drejtë të paraqesë publikisht opinionin e tij kundërshtues.

Neni 16

**Vlerësimi i jashtëm dhe sigurimi i cilësisë**

1. Këshilli Fiskal i nënshtrohet një vlerësimi të jashtëm të pavarësisë, efektivitetit dhe kryerjes së mandatit të tij, të paktën një herë në çdo 6 vjet.

2. Vlerësimi i jashtëm kryhet nga një organizatë ndërkombëtare e specializuar në fushën e financave publike ose nga një panel vlerësuesish të pavarur nga Këshilli Fiskal dhe nga autoritetet publike shqiptare. Vlerësuesi përzgjidhet nga komisioni parlamentar përgjegjës për financat, me propozim të Këshillit Fiskal.

3. Shpenzimet për kryerjen e vlerësimit të jashtëm përballohen nga buxheti i Këshillit Fiskal. Në kërkesën e tij buxhetore, për vitin në të cilin do të kryhet vlerësimi, Këshilli Fiskal parashikon një fond të veçantë për këtë qëllim. Vlerësimi mund të financohet gjithashtu, tërësisht ose pjesërisht, nga asistenca teknike ose nga burime të tjera të jashtme, me kusht që kjo të mos ndikojë në pavarësinë e vlerësuesve ose në objektivitetin e vlerësimit.

4. Raporti i vlerësimit të jashtëm publikohet në faqen e internetit të Këshillit Fiskal brenda 30 ditëve dhe i paraqitet Kuvendit. Brenda 60 ditëve nga publikimi i raportit, Këshilli Fiskal miraton dhe publikon një plan veprimi në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të tij, si dhe raporton për zbatimin e këtij plani në raportet vjetore të veprimtarisë.

## KREU VII
## BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE DHE ME PERSONAT FIZIKË E JURIDIKË

### Neni 17
### **Aksesi në informacion dhe bashkëpunimi**

1. Për ushtrimin e funksioneve të tij, Këshilli Fiskal ka të drejtë të kërkojë e të marrë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë e tjera publike, në nivel qendror e vendor, çdo informacion dhe të dhënë të nevojshme që lidhet me fushën e veprimtarisë së tij.

2. Njësitë publike janë të detyruara t'i vënë në dispozicion Këshillit Fiskal informacionin dhe të dhënat e kërkuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Informacioni dhe të dhënat sigurohen në format elektronik të modifikueshëm dhe, sipas rastit, shoqërohen me dokumentacionin përkatës.

3. Refuzimi i plotë ose i pjesshëm i vënies në dispozicion të informacionit argumentohet me shkrim. Këshilli Fiskal ka të drejtë të bëjë publike rastet e njësive publike, që nuk respektojnë detyrimet e parashikuara në këtë nen.

4. Këshilli Fiskal mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për statistikat zyrtare, njësitë e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, fondet speciale dhe entitete të tjera publike, në nivel qendror e vendor, si dhe me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim sigurimin në kohë të informacionit të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të tij, si dhe për rregullimin e procedurave të bashkëpunimit.

5. Këshilli Fiskal merr pjesë në veprimtaritë e rrjeteve dhe shoqatave evropiane e ndërkombëtare të këshillave fiskalë, si dhe bashkëpunon me institucione e organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 18
**Konfidencialiteti i informacionit**

1. Anëtarët e Këshillit Fiskal, sekretariati teknik, punonjësit, ekspertët e jashtëm dhe çdo person tjetër, i angazhuar nga Këshilli Fiskal, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni jopublik për të cilin marrin dijeni gjatë ushtrimit të detyrave ose veprimtarisë së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Informacioni konfidencial përdoret vetëm për qëllime të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të Këshillit Fiskal dhe nuk u vihet në dispozicion palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pas përfundimit të mandatit, marrëdhënies së punës, marrëdhënies kontraktuale apo çdo forme tjetër angazhimi me Këshillin Fiskal.

4. Këshilli Fiskal miraton procedurat dhe masat e nevojshme për garantimin e mbrojtjes, ruajtjes e të administrimit të informacionit konfidencial, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë detyrimin e Këshillit Fiskal për publikimin e opinioneve, analizave, raporteve, vlerësimeve dhe dokumenteve të tjera, në përputhje me këtë ligj.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 19
**Afati për paraqitjen e propozimeve për anëtarët e Këshillit Fiskal**

1. Komisioni përgjegjës për ekonominë dhe financat ka detyrimin t'i propozojë Kuvendit anëtarët e Këshillit Fiskal brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Këshilli Fiskal konstituohet dhe fillon veprimtarinë e tij pasi të jenë zgjedhur të tre anëtarët.

Neni 20
**Shkallëzimi i mandateve të përbërjes së parë të Këshillit Fiskal**

1. Në përjashtim nga pika 2 e nenit 6 të këtij ligji, anëtarët e përbërjes së parë të Këshillit Fiskal emërohen me mandate fillestare prej 6 (gjashtë), 5 (pesë) dhe 4 (katër) vjetësh.

2. Kohëzgjatja e mandatit fillestar të secilit prej anëtarëve të përbërjes së parë përcaktohet me short, i cili hidhet në një mbledhje publike të komisionit parlamentar përgjegjës për financat, menjëherë pas emërimit të tre anëtarëve nga Kuvendi, pasqyrohet në procesverbalin e asaj mbledhjeje dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit.

3. Me përfundimin e një mandati fillestar, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, anëtari pasardhës emërohet për një mandat të plotë prej 6 (gjashtë) vjetësh, në përputhje me pikën 2, të nenit 6 të këtij ligji.

4. Mandati fillestar, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, llogaritet si mandat për qëllime të kufizimit të riemërimit, të parashikuar në pikën 2, të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 21

**Afatet e vënies në funksionim të Këshillit Fiskal**

1. Brenda 90 ditëve nga data e emërimit, Këshilli Fiskal shpall konkurrimin publik për përzgjedhjen e anëtarëve të sekretariatit teknik.

2. Brenda 60 ditëve nga data e emërimit, Këshilli Fiskal miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të tij.

Neni 22

**Dispozitë kalimtare**

Dispozitat e pikave 4, 5, 6 dhe 7, të nenit 5 të këtij ligji zbatohen nga data e konstituimit të Këshillit Fiskal, sipas pikës 2, të nenit 19 të këtij ligji.

Neni 23

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.10.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 583, datë 2.11.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj**